



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



	REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNES / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET		
Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)		
Nr./Br./No	722	Nr. i faq./Br. str./No. pg. 164
Data/Datum/Date	8 / 6 / 23	
RAHOVEC / ORAHOVAC		

Procesverbal i takimeve publike me qytetarë për
kërkesat e tyre dhe ecurinë e projekteve
në **Ratkoc, Dejnë, Vrajak, Bratotin, Malësi e Vogël,**
Gexhë

INFORMATË RRETH NJOFTIMEVE

Njoftimi për organizimin e takimeve publike me qytetarë për kërkesat e tyre dhe ecurinë e projekteve, u publikua me datë: 18.5.2023 në ueb faqen e komunës së Rahovecit, në të dy gjuhët, në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/05/NJOFTIM-TAKIMET-ME-QYTETAR-RATKOC-DEJNE-VRAJAK-BRATOTIN-MALESI-E-VOGEL-1.pdf>, në harmoni me afatet ligjore që i përcakton Udhëzimi Administrativ, si vijon:

Në mbështetje të nenit 68, paragrafi 68.1 i Ligjit Nr.03L-40 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 17 dhe nenit 18 paragrafi 1, pika 1.7, të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, të datës: 29.03.2017, Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publike në Komuna, kryetari i Komunës, Smajl Latifi organizon takime publike me qytetarë për kërkesat e tyre dhe ecurinë e projekteve në fshatra dhe vendbanime të komunës së Rahovecit.

Me qëllim të rritjes së nivelit të transparencës e llogaridhënies dhe për t'i mbajtur sa më të informuar banorët e komunës së Rahovecit, rreth orarit dhe vendit të mbajtjes së takimeve publike, janë bërë me kohë planifikimet dhe është publikuar me kohë kalendar i takimeve publike për në vendbanimet e komunës së Rahovecit në këtë vegëz: Kalendar për organizimin e takimeve publike me qytetarë për kërkesat e tyre dhe ecurinë e projekteve, u publikua me datë: 18.5.2023 në të dy gjuhët, në këtë link:

<https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/05/Kalendari-i-takimeve-me-qytetare.pdf>

Poashtu, bazuar në afatet ligjore janë njoftuar me kohë banorët e secilit vendbanim rreth mbajtjes së takimeve me anë të publikimit të secilit njoftim veç e veç, për secilën ditë të takimit, në ueb faqe të komunës, shtatë ditë para mbajtjes së dëgjimit në atë vendbanim.

Njoftimet përveç që janë publikuar në uebfaqe të komunës, në Platformën për Konsultime Publike, në rrjetin social Facebook, njoftimet u janë dërguar edhe kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane përmes rrjeteve sociale Viber.

TAKIMI PUBLIK NË RATKOC, DEJNË, VRAJAKË, BRATOTIN, MALËSI E VOGËL DHE GEXHË

Më datë: **5.6.2023** mbahen takimet publike me qytetarët në fshatrat:Ratkoc, Dejnë, Vrajakë, Bratotin, Malësi e Vogël dhe Gexhë. Të pranishëm kanë qenë Kryetari i Komunës së Rahovecit, nënkryetari, disa drejtorë të drejtorive, zyrtarë komunal.

Takimi filloi në orën 19:20

Takimin e shpalli të hapur kryetari Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi duke i përshëndetur gjithë të pranishmit dhe i falenderoi për pjesëmarrjen. Karakteri i takimit është ti dëgjojmë kërkesat dhe nevojat tuaja, pastaj do ju përgjigjemi veçmas për secilen prej tyre,

Mensur Hoti, Ratkoc- Përshëndetje për të gjithë, kam një kërkesë te rruga 12 Maji në bashkëpunim me KEDS-in jemi dakorduar që 6 shtylla elektrike të na sigurojnë ata dhe 6 me shpenzime tona, po kërkojmë nga komuna që më pastaj të kemi ndriçim publik në këtë rrugë.

Sali Krasniqi, Ratkoc- I nderuar kryetarë, në rrugën Qazim Miftari nuk kemi kanalizim, kam bërë disa herë kërkesë në komunë, por nuk kam marrë përgjigje konkrete.

Sokol Hoti, Ratkoc- Mirëmbërma për të gjithë pjesëmarrësit, i nderuar kryetarë, kërkojmë nga ju që ta rregulloni rrugën mbi varreza, sa here ka reshje atmosferike është pothuajse e pakalueshme.

Nexhmedin Krasniqi, përfaqësues i fshatit Gexhe- Të nderuar të pranishëm, përshëndetje për të gjithë. Po i paraqesim disa nga kërkesat tona: kubëzimi te oda e fshatit si dhe 3 rrugë tjera për kubëzim dikun afro 50-60 metra, ndriçimi public te lagjja e Morinve.

Murat Morina, përfaqësues i fshatit Malësi e Vogël- Ju përshëndes të gjithëve, i nderuar kryetarë, bashkëpunëtor dhe ju qytetarë. Ne si kryesi e fshatit po i paraqesim disa nga kërkesat me prioritet:

- Kanalizim,
- Vazhdimin e rregullimit të përroit të fshatit, afro 10 metra,

- Rregullimin e rrugës së varrezave.

Bujar Hoti, Ratkoc: Unë po e paraqesë një kërkesë për një kanalizim rrugës në drejtim të fshatit Dejnë.

Arber Morina, Ratkoc: I nderuar drejtor i Sherbimeve Publike, po ju drejtohem juve sepse kërkesën time e adresoj tek drejtoria përkatëse, disa shtylla elektrike janë dëmtuar shume, kush e merr përgjegjësinë në rregullimin e tyre.

Bujar Himaj, Gexhe: Përshëndetje kryetarë, staf dhe ju të pranishëm, kemi një shqetësim sa herë ka të reshura atmosferike te shkolla, po kërkojmë pastrimin e kanalit të ujrave atmosferike.

Avni Morina, Drejtori i Arsimit: Ju përshëndes të gjithëve, po i theksoj disa nga investimet në këto lokalitete: *Gexhe*- projekti i efciences në shkollë, i cili pritët të përfundojë deri me 31 gusht 2023, *Malësi e Vogël*-pajisja e kabinetit të fizikes me mjete konkretizimi dhe laboratorike, fusha sportive në ndërtim e sipër, *Ratkoc*- ndërtimi i objektit të shkollës-në proces, përrurimi i çerdhes për fëmijë, projekti i efciences në SHML “12 Maji”, pajisja e bibliotekes me libra në SHML “12Maji”, *Vrajak dhe Bratotin*- ndërtimi i shkollës së re, pothuajse në përfundim, pajisja e kabinetit të biologjisë me mjete konkretizimi dhe mjete laboratorike. *Dejnë*- së shpejti do të fillojnë riparimet në objektin e shkollës Rudolf Walther në Dejnë.

Perparim Krasniqi, drejtor i Sherbimeve Publike:

Dejnë:

1. Disa rruge te përfunduara, disa janë në proces
2. Në proces edhe trotuaret,
3. Ndriçimi publik i përfunduar, pritët zëvendësimi i poçave nga esco
4. Mirëmbajtja e varrezave dhe hapësirave tjera publike e rregullt.

Malësi e Vogël:

1. Segmentet e kanalizimit te planifikuara, dy segmente janë përfunduar
2. Ndriçimi publik i përfunduar, pritët te zëvendësohen me ESCO
3. Mirëmbajtja e rregullt e hapësirave publike,

4. Ndërtim të rrugëve lokale, ne proces te ritenderimit(pas shkëputjes se kontratës me OE)
5. Mirëmbajtja e varrezave dhe hapësirave tjera publike e rregullt

Ratkoc:

1. Te përfunduara një mori segmentesh të kanalizimit, problemet me të mbeten ende, mirëpo planifikohet të ndërtohet një kolektor i ri,
2. Ndriçimi publik në proces,
3. Ndërtimi i rrugëve në proces, të planifikuara 20 segmente rrugore me kubeza,
4. Ndërtimi i trotuarit, në proces vazhdim i projektit
5. Mirëmbajtja e rregullt e hapësirave publike

Vrajak:

1. Në proces të vlerësimit ofertat për ndërtimin e disa rrugëve,
2. Ndriçimi publik në proces, jemi duke punuar, afër finalizimit,
3. Mirëmbajtja e rregullt e hapësirave publike

Bratatin:

1. Në proces të vlerësimit ofertat për ndërtimin e rrugëve,
2. Ndriçimi publik në proces, jemi duke punuar,
3. Mirëmbajtja e rregullt e hapësirave publike.

Albnor Mullabazi, drejtor i Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit: Përsëritet për të gjithë, disa nga investimet janë: ndërtimi i parkut në fshatin Ratkoc, ndërtimi i shtratit të përroit.

Besmire Bytyqi, drejtoreshë për Mbrojtje dhe Shpëtim: Ju përsëritet të gjithëve, unë kërkojë nga ju për bashkëpunim, duke e ditur se gjatë sezonit të verës gjasat për përfshirje të zjarreve janë më të mëdha, te kemi kujdes më të shtuar në këtë aspekt.

Afrim Oruqi, drejtor për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë: Të nderuar qytetarë, unë ju bëjë thirrje për ruajtje të pronës publike.

Erhan Morina, drejtor për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizem: Po ju njoftoj lidhur me Tregun Ditor në Ratkoc, ka kaluar në kivend komunal, do të ju lajmrojmë deri të kthehet ligjshmëria për shfrytëzim.

Berat Duraku, drejtor i Bujqësisë: Sa i përket rrugëve fushore, në këto lokalitete janë pothuajse të përfunduara për shkak se operatori ekonomik e kry punen me përgjegjshmëri, ndërtimi i kanalit të

kullimit të lagjia e Morinve dhe pjesa tjetër deri në Dri, ka vazhduar shpërndarje e pajisjeve bujqësore, trajtimi i qenve endacak, vaksinimi dhe kontrollimi i vazhdueshëm i bagëtive.

Smajl Latifi, kryetar i komunës: Ju falenderojë për kërkesat tuaja, faleminderit edhe prej të gjitha drejtorive për përgjigjet konkrete. Do të plotësojë disa shqetësimi tuaja që i keni paraqitur, tek kanalizimi i ujrave të zeza kemi probleme me kolektorët e ujrave atmosferik, po ju informojë që së shpejti do të bëhet digjitalizimi i ndriçimit publik, tek shtrembërimi i shyllave aty dikush i ka dëmtuar, por do të kujdesemi në rregullimin e tyre, ndërtimi i rrugëve do të trajtohet në mënyrë të veçantë.

Rregullimi i fushës sportive në Gexhe, më 3 Maj 2023 kemi filluar rregullimin e fushës sportive në Malësi të Vogël, punimet janë duke vazhduar, në amfiteatrin ku mbahet festivali “Anadrinia Jehon” është bërë rregullimi i ulësëve të cilat i kanë dëmtuar qytetarët.

LISTA E NËNSHKRIMEVE



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republika of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahevac/Municipality Orahevac



Lista e nënskrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në takim publik me qytetarë, me banorë të fshatrave: Ratkoc, Dejë, Vrajkë, Haraot, Malësi e Vogël, Gexhe.

Nr	Emri	Mbiemri	Vendi	Nënskrimi
1.	Pasun	Imam	H. E. Vogel	
2.	Milutin	Mosina	P. E. Vogel	
3.	Ardi	Kramir	M. E. Vogel	
4.	Isa	Reza	H. E. Vogel	
5.	Edel	Hoti	RATKOC	
6.	Adil	Hoti	RATKOC	
7.	Reza	Hoxha	Gexhe	
8.	Reza	Hoti		
9.	Nexhmë	HASUQI	GEXHE	
10.	Rustem	Hoti	RATKOC	
11.	Buyer	Hoti	RATKOC	
12.				
13.	FATI	HOTI	RATKOC	
14.	CEPI	JALA	RATKOC	
15.	BAJAN	HOTI	RATKOC	
16.	Must	HOTI	RATKOC	
17.	ARBER	MORINA	RATKOC	
18.	SINAN	HOTI	RATKOC	
19.	Arben	Hoti	RATKOC	
20.	Qosim	MORINA	RATKOC	
21.	Mujtim	Hoti	RATKOC	
22.	MIRK	HOTI	RATKOC	
23.	BAJAN	HOTI	RATKOC	
24.	TRHIR	HOTI	RATKOC	
25.	SHAN	HOTI		

Me 2.6.2023

KOMUNA E RAHOVECIT - Procesverbal i takimeve publike me qytetarë për kërkesat e tyre dhe ecurinë e projekteve

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Račava / Municipality Rahovec

Liste e shtesë rreth të zyrësve që punojnë në takimin publik me qytetarët, me bazë të listës së
Rahovec, Dajç, Vranjski, Bistrica, Malesi e Vogël, Gërra

Nr	Familja	Niveli	Vendi	Niveli
1.	HAJRI	HOTI	RAKOC	HAJRI
2.	SALI	KRIVICA	RAKOC	SALI
3.	ALIBERI	HAJRI	RAKOC	ALIBERI
4.	KRIVICA	HAJRI	RAKOC	KRIVICA
5.	HAJRI	HOTI	RAKOC	HAJRI
6.	HAJRI	HOTI	RAKOC	HAJRI
7.	HAJRI	HOTI	RAKOC	HAJRI
8.	HAJRI	HOTI	RAKOC	HAJRI
9.	HAJRI	HOTI	RAKOC	HAJRI
10.	HAJRI	HOTI	RAKOC	HAJRI
11.	HAJRI	HOTI	RAKOC	HAJRI
12.	HAJRI	HOTI	RAKOC	HAJRI
13.	HAJRI	HOTI	RAKOC	HAJRI
14.	HAJRI	HOTI	RAKOC	HAJRI
15.	HAJRI	HOTI	RAKOC	HAJRI
16.	HAJRI	HOTI	RAKOC	HAJRI
17.				
18.				
19.				
20.				
21.				
22.				
23.				
24.				
25.				

Me 24.02.2023

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Račava / Municipality Rahovec

Liste e shtesë rreth të zyrësve që punojnë në takimin publik me qytetarët, me bazë të listës së
Rahovec, Dajç, Vranjski, Bistrica, Malesi e Vogël, Gërra

Nr	Familja	Niveli	Pacita	Niveli
1.	HAJRI	HAJRI	Z. B. RAKOC	HAJRI
2.	ALIBERI	HAJRI	Dajç - Dajç	ALIBERI
3.	HAJRI	HAJRI	Dajç - Dajç	HAJRI
4.	HAJRI	HAJRI	Dajç - Dajç	HAJRI
5.	HAJRI	HAJRI	Dajç - Dajç	HAJRI
6.	HAJRI	HAJRI	Dajç - Dajç	HAJRI
7.	HAJRI	HAJRI	Dajç - Dajç	HAJRI
8.	HAJRI	HAJRI	Dajç - Dajç	HAJRI
9.	HAJRI	HAJRI	Dajç - Dajç	HAJRI
10.	HAJRI	HAJRI	Dajç - Dajç	HAJRI
11.	HAJRI	HAJRI	Dajç - Dajç	HAJRI
12.	HAJRI	HAJRI	Dajç - Dajç	HAJRI
13.	HAJRI	HAJRI	Dajç - Dajç	HAJRI
14.	HAJRI	HAJRI	Dajç - Dajç	HAJRI
15.				
16.				
17.				
18.				
19.				
20.				

Me 24.02.2023

FOTOGRAFI





Ju faleminderit për pjesëmarrjen tuaj!

Takimi përfundoi në ora 20:35.

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

Rahovec, qershor 2023